

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

Nr	Data e Kërkesës ¹	Objekti I Kërkesës ²	Data e Përgjigjes ³	Përgjigje ⁴	Mënyra e përfundimit të kërkesës ⁵	Tarifa ⁶
1	31.07.2023	Kërkesë për informacion për Njehsim diplome nga IAL	02.08.2023	Përsëndetje, Duke qënë se kërkesa juaj për informacion është specifike, ne kemi nevojë për më shumë detaje për rastin tuaj që t'ju ndihmojmë. Ju lutemi na kontaktoni në kanalën tonë të komunikimit live chat në faqen tonë zyrtare https://www.adisa.gov.al nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00 për t'ju sqaruar hap pas hapi për rastin tuaj. Faleminderit.	E plotë	Nuk ka
2	01.08.2023	Kërkesë për informacion për passportë biometrike	02.08.2023	Përsëndetje, Në vijim të kërkesës tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se, për të rezervuar orar për kryerjen e passportës, ju duhet të drejtoheni pranë zyrave të Identitek, ose ish-Aleat. Paraprakisht, duhet të keni në dorë kuponin e marrë nga posta dhe me pas të paraqiteni për rinovimin e passportës. Për çdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00, ose na kontaktoni në live-chat online në faqen tonë zyrtare https://www.adisa.gov.al/ . Faleminderit!	E plotë	Nuk ka

¹ Data e regjistrimit të kërkesës

² Përmbledhje e objektit të kërkesës duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi

³ Data e kthimit të përgjigjes

⁴ Përmbajtja e përgjigjes duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi

⁵ Përgjigja jepet E plotë/ E kufizuar/ E refuzuar/E deleguar

⁶ Kosto monetare e riprodhimit (kur është rasti dhe e dërgimit) të informacionit të kërkuar sipas tarifave të publikuar nga autoriteti publik

3	01.08.2023	Kërkesë për informacion për vërtetim pune	02.08.2023	Përhëndetje, Në vijim të pyetjes suaj, ju bëjmë me dije se Vërtetimi nuk merret për periudha paraardhëse. Nëse qytetarit i ka ndryshuar statusi nga i papunë, në i punësuar, nuk gjeneroni dot vërtetim papunesie. Megjithatë, ekziston mundësia që ju të noteroni kartonin e papunësisë, në rast se e keni atë. Për cdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00 ose në kanalën e ri të komunikimit (online chat) nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!	E plotë	Nuk ka
4	02.08.2023	Kërkesë për informacion për shpallje martesë mes dy shtetasve shqiptarë	02.08.2023	Përhëndetje, Në vijim të kërkesës tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se fillimisht duhet të kryeni shpalljen e martesës. Procedura për të bërë shpalljen e martesës mes dy shtetasve shqiptarë në Republikën e Shqipërisë është si më poshtë vijon : Kërkesa për shpallje bëhet nga bashkëshortët e ardhshëm ose nga personi i caktuar nga ata me prokurë të posaçme. Shpallja e martesës bëhet nga të dy bashkëshortët e ardhshëm në zyrat e gjendjes civile në bashki / njësi administrative ku kanë vendbanimin. Gjatë shpalljes së martesës bashkëshortët e ardhshëm do të përcaktojnë se në cilën zyrë të gjendjes civile do të lidhet martesë. Dokumentet e nevojshëm për shpalljen e martesës janë: prokurë e posaçme, në rastet kur bashkëshortët e ardhshëm nuk janë prezent në procedurën e shpalljes; certifikatë lindje, me shënimin “për shpallje martesë”;fotokopje e dokumentit të identifikimit; Martesa nuk mund të lidhet para se të kalojnë 10 ditë nga e nesërmja e shpalljes. Afati i vlefshmërisë për lidhjen e martesës së shpallur është 1 vit. Pas kalimit të afatit 10 ditor nga e nesërmja e shpalljes, secili nga bashkëshortët e ardhshëm pajiset me dokumentin certifikatë lindje për lidhje martesë. Në ditën e caktuar për lidhjen e martesës duhet të jenë të pranishëm dhe dy dëshmitarë. Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!	E plotë	Nuk ka
5	02.08.2023	Kërkesë për informacion për lidhje martesë	02.08.2023	Përhëndetje, Në vijim të kërkesës tuaj për informacion , Ju bëjmë me dije se pjesë e aktit të lidhjes së martesës janë dy dëshmitarë. Për cdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!	E plotë	Nuk ka

6	02.08.2023	Kërkesë për informacion për lidhje martese midis një shtetasi shqiptar dhe një shtetasi të huaj	03.08.2023	Përsëritet, Në vijim të kërkesës tuaj për informacion , Ju bëjmë me dije se hapi i parë i lidhjes së martesës, është shpallja e martesës. Procedura për të bërë shpalljen e martesës midis një shtetasi shqiptar dhe një shtetasi të huaj është si më poshtë vijon : Në rastin e lidhjes së martesës me një shtetas të huaj, nga bashkëshorti i ardhshëm (shtetasi i huaj) paraqiten dokumentet për shpalljen e martesës, të legalizuar, përkthyer, noteruar: certifikatë lindje, e plotësuar me të gjithë përbërësit e gjendjes civile, që pasqyrohen në rubrikat e Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile; dokumentin / certifikatë që vërteton se nuk ka pengesë ligjore në vendin e tij për lidhje martese (vërtetim për leje lidhje martese); dokument ku vërtetohen të dhënat e vendbanimit në shtetin e huaj; fotokopje e dokumentit të identifikimit; Këto dokumenta duhet të jenë me vulë APOSTILLE ose të legalizuar nga përfaqësitë tona diplomatike jashtë vendit. Dokumentacioni duhet të paraqitet i përkthyer dhe i noteruar Shpallja e martesës kryhet në Bashki / Njësi Administrative, ku ka vendbanimin bashkëshorti i ardhshëm (shtetasi shqiptar). Pas kalimit të afatit 10 ditë nga e nesërmeja e shpalljes, shtetasi shqiptar që do të lidhë martesë pajiset me dokumentacionin e mëposhtëm: certifikatë lindje; certifikatë lindje me shënimin “për lidhje martese”; Dokumentet duhet të legalizohen në institucionin e Prefekturës dhe në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe më pas bashkëshortët e ardhshëm ndjekin procedurën sipas legjislacionit të vendit ku do të lidhet martesa. Aplikimet për legalizimin e dokumenteve kryhen nëpërmjet Postës Shqiptare. Pas lidhjes së martesës në shtetin e huaj, dokumenti i martesës (certifikatë martese/ekstrakt akt martese) i legalizuar, përcillet për regjistrim në shërbimin e gjendjes civile në Shqipëri në zyrën e gjendjes civile, ku bashkëshorti shqiptar ka vendbanimin. Për çdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00, ose na kontaktoni në live chat online, në faqen tonë zyrtare https://www.adisa.gov.al/ Faleminderit!	E plotë	Nuk ka
7	03.08.2023	Kërkesë për informacion për	03.08.2023	Përsëritet , Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion , Ju informojmë se për të saktësuar adresën tuaj duhet të aplikoni online nëpërmjet e-albania shërbimit : Aplikim për ndryshim/saktësim vendbanimi në linkun https://e-	E plotë	Nuk ka

		ndryshim vendbanimi		albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=14419 - Klikoni butonin "Përdor"; - Plotësoni të dhënat e kërkuara në formular lidhur me adresën e re të vendbanimit. <i>Plotësimi i elementëve të adresës duhet të bëhet sipas formatit të adresës të cilën e gjeni tek Regjistri Kombëtar</i> Adresave http://adresari.mb.gov.al/map/ ; - Ngarkoni dokumenti që vërteton pronësinë/përdorimin e banesës dhe klikoni butonin "Dërgo". Për cdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!		
8	03.08.2023	Kërkesë për informacion për shpallje martesë mes dy shtetasve shqiptarë	04.08.2023	Pershendetje! Në vijim të kërkesës tuaj për informacion, ju bëjmë me dije se nëse keni shtetësi shqiptare do bëni procedurën e martesës si shtetase shqiptare dhe jo greke. Për më tepër informacion ju mund të interesoheni edhe në Zyrën e Gjendjes Civile. Megjithatë, Në rast se jeni në Greqi aplikoni për prokurë të posaçme nëpërmjet konsullatës dhe autorizoni partnerin shqiptar në Shqipëri të bëjë shpalljen e martesës edhe për ju Por ama, duhet të keni kartë identiteti shqiptare të vlefshme që të bëni shpalljen. Bashkëlidhur gjeni linkun: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=9783 Për cdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00, ose na kontaktoni ne live chat online ne faqen tone zyrtare https://www.adisa.gov.al/ Faleminderit!	E plotë	Nuk ka
9	04.08.2023	Kërkesë për informacion për gjenerim passwordi	04.08.2023	Përhëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se nëse nuk arrini të logoheni (futeni) në llogarinë Tuaj në e-albania, nëse nuk keni aktive asnjë nga të dhënat e regjistrimit(adresë email dhe numër telefoni) për të gjeneruar një pasword të ri duhet të veproni si më poshtë: Hapni një adresë të re email ose nese keni nje aktive ne perdorim dhe dërgoni këto të dhëna në adresën: helpdesk@e-albania.al - foto të kartës ID - emri i nënës - emri i babait - datëlindja e nënës. Specifikoni adresën e re email që doni të përdorni në vazhdim për llogarinë tuaj në portal. Brenda 5(pesë) ditëve adresa ku keni dërguar email-in do t`Ju pajisë me një kod katërshifror me anë të të cilit zhbllkohet llogaria dhe u jep të drejtën të vendosni një fjalëkalim të ri. Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!	E plotë	Nuk ka

10	04.08.2023	Kërkesë për informacion për login në portalin e-albania	04.08.2023	Përhëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se: Regjistrimi në portalin qeveritar e-Albania mund të kryhet si për shtetasit shqiptarë, ashtu dhe për shtetasit e huaj të pajisur me leje qëndrimi në Shqipëri. Shtetasit shqiptarë regjistrohen nëpërmjet Numrit Personal të Identifikimit, të cilin e gjejnë në kartën e tyre të identitetit. Pasi të jetë hapur portali www.e-albania.al duhet të ndiqen hapat e mëposhtëm: Klikoni "Regjistrohu/Register". Plotësoni të gjitha të dhënat e specifikuar në formularin e regjistrimit. Kodi i përdoruesit (NID: Numri personal i identifikimit) / User Personal Identification Number (NID) : Është numri personal i identifikimit.Data e skadimit të kartës së identitetit / Identification document expiry date: Vendosi datën e skadimit të kartës së identitetit në formatin datë.muaj.vit.Fjalëkalimi / Password: Sigurohuni që fjalëkalimi të jetë 8 deri në 12 karaktere i gjatë dhe nuk duhet të fillojë ose mbarojë me hapësira.E-mail: Në këtë adresë do të vijë linku i aktivizimit të llogarisë dhe të gjitha njoftimet që kanë të bëjnë me aplikimet tuaja. Numri i celularit / Mobile phone number: Sigurohuni që të vendoset në formatin e duhur. Për numrat shqiptarë formati është '06xxxxxxxx' ndersa për numrat jashtë Shqipërisë, formati i saktë është '0044/0039/0032xxxxxxxx', në varësi të shtetit ku jetoni. Të dhënat personale (Emri / Name, Mbiemri / Surname, Atësia / Father Name, Mëmësia / Mother Name, Datëlindja / Birthdate): Duhet të bëhet kujdes që të gjitha të dhënat të jenë të sakta dhe të përputhen me të dhënat e Regjistrimit të Gjendjes Civile. * Kujdes me të dhënat që mund të kenë "ë", ose "ç". Nëse edhe pas verifikimit të të dhënave tuaja në Gjendjen Civile do të keni vështirësi me regjistrimin kontaktoni ne adresën : helpdesk@e-albania.al. Plotësoni kodin katër shifror të dërguar me SMS në numrin tuaj të telefonit dhe klikoni në linkun e aktivizimit në adresën tuaj e-mail për aktivizimin e llogarisë tuaj. Për çdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!	E plotë	Nuk ka
11	09.08.2023	Kërkesë për informacion për	09.08.2023	Përhëndetje, Në zbatim të ligjit nr. 119, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit” neni 10, pika “d” përcakton se: “Koordinatori i të drejtës së informimit të një autoriteti publik, dërgon kërkesën për informim te një	E deleguar	Nuk ka

		gjenerim passwordi		autoritet tjetër publik, brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, kur rezulton se autoriteti publik ku është depozituar kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar”. Si rrjedhojë, gjeni mëposhtë kërkesën e qytetarit: Nuk mbaj mend passwordin e as email te e-albania te vjetrin.		
12	04.08.2023	Kërkesë për informacion për gjenerim passwordi	14.08.2023	Përhëndetje! Në vijim të kërkesës tuaj për informacion, ju bëjmë me dije se ju duhet të kontaktoni suportin teknik të portalit e-albania për t'ju ndihmuar me problematikën tuaj. Këtu gjeni adresën ku mund të shkruani problematikën tuaj: helpdesk@e-albania.al Faleminderit!	E plotë	Nuk ka
13	04.08.2023	Kërkesë për informacion për ndryshim vendbanimi	14.08.2023	Përhëndetje, Në vijim të kërkesës tuaj për informacion, ju bëjmë me dije se, koha e marrjes së shërbimit për shërbimin ndryshim vendbanimi është 24 orë nga momenti i aplikimit. Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!	E plotë	Nuk ka
14	07.08.2023	Kërkesë për informacion për certifikatë familjare	14.08.2023	Përhëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se duhet të aplikoni shërbimin "Certifikatë familjare (për përdorim brenda vendit/ për përdorim nga autoritetet e huaja)". Shërbimi elektronik "Certifikatë familjare (për përdorim brenda vendit/ për përdorim nga autoritetet e huaja)" ju mundëson të shikoni dhe verifikoni të dhënat familjare dhe të gjeneroni certifikatën familjare me vulë elektronike në shqip ose gjuhë të huaj, për përbërjen familjare aktuale dhe të mëparshme (historike) sipas tipologjisë: • Certifikatë familjare aktuale (për përdorim brenda vendit/ për përdorim nga autoritetet e huaja), nëpërmjet së cilës mundësohet verifikimi i të dhënave familjare për periudhën aktuale për të cilën kërkohen. Certifikatë familjare për regjistrime të mëparshme (për përdorim brenda vendit/ për përdorim nga autoritetet e huaja), nëpërmjet së cilës mundësohet verifikimi i të dhënave familjare të një historiku të mëparshëm në shqip ose gjuhë të huaj sipas periudhave të mëposhtme: - Për periudhën nga viti 1923 deri në vitin 2010, “Certifikata familjare për regjistrime të mëparshme” (për përdorim brenda vendit/ për përdorim nga autoritetet e huaja), do të mundësohet nga zyra e gjendjes civile përkatëse. - Për periudhën pas vitit 2010 “Certifikata familjare për regjistrime të mëparshme” (për përdorim brenda vendit/ për përdorim nga autoritetet e huaja) do të mundësohet nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile (RKGjC) i	E plotë	Nuk ka

				vitit 2010. Certifikata familjare gjenerohet me vulë elektronike në shqip ose në gjuhë të huaj. “Certifikata familjare aktuale” dhe “Certifikata familjare për regjistrime të mëparshme”, pas vitit 2010, gjenerohet <i>menjëherë</i>. “Certifikata familjare për regjistrime të mëparshme” për periudhën 1923 - 2010, lëshohet <i>brenda 3 (tre) ditëve pune</i>. Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!		
15	07.08.2023	Kërkesë për informacion për transferim nga gjimnazi në gjimnaz	14.08.2023	Përhëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se transferimi i nxënësit, si rregull, bëhet pas përfundimit të vitit shkollor ose pas përfundimit të njërit prej tremujorëve, kurse në raste të ndërrimit të vendbanimit në një ZVA tjetër gjatë vitit shkollor. Personi që ushtron përgjegjësin prindërore mund të bëjë një aplikim online ku plotëson të dhënat e nevojshme të formularit. https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=13711 Dokumenti që shoqëroj aplikimin është: 1. Dëftesë e klasës paraardhëse. Në kërkesën për informacion nuk keni referuar nëse transferimi vjen si pasojë e transferimit të vendbanimit, pasi në të kundërt duhet të aplikoni dhe ndryshimin e tij. Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!	E plotë	Nuk ka
16	07.08.2023	Kërkesë për informacion për certifikatë trangu familjar	14.08.2023	Përhëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se Certifikatat e Trungut Familjar nuk mundësohen në e-albania. Për këto certifikata, procedohet si më poshtë: Për qytetet e Tiranës, certifikatat merren tek Bashkia Tiranë. Për rrethinat e Tiranës merren tek Prefektura Tiranë. Për të gjitha Bashkitë e Komunat e tjera në territorin e Shqipërisë, certifikatat merren pranë Prefekturave të Qarqeve respektive. Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit	E plotë	Nuk ka
17	07.08.2023	Kërkesë për informacion për lidhje martesë	14.08.2023	Përhëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bejme me dije se hapi i pare per lidhjen e marteses, eshte shpallja e marteses. Kërkesa për shpallje bëhet nga bashkëshortët e ardhshëm ose nga personi i caktuar nga ata me prokurë të posaçme. Shpallja e martesës bëhet nga të dy bashkëshortët e ardhshëm në zyrat e gjendjes civile në bashki / njësi administrative ku kanë vendbanimin. Gjatë shpalljes së martesës bashkëshortët e ardhshëm do të	E plotë	Nuk ka

				përcaktojnë se në cilën zyrë të gjendjes civile do të lidhet martesa. Dokumentacioni i nevojshem për shpalljen e martesës midis dy shtetasve shqiptarë në republikën e Shqipërisë është: certifikatë lindje, me shënimin “për shpallje martese” e cila merret pranë sporteve të gjendjes civile, fotokopje e dokumentit të identifikimit, (karta e identitetit) brenda afatit të vlefshmërisë, prokurë e posaçme, në rastet kur bashkëshortët e ardhshëm nuk janë prezent në procedurën e shpalljes; Për çdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!		
18	07.08.2023	Kërkesë për informacion për Njehsim diplome nga IAL	14.08.2023	Përhëndetje, Në vijim të kërkesës tuaj për informacion ju bëjmë me dije se për të njehsuar diplomën angleze në shtetin shqiptar, ju duhet ta noterizoni dhe përktheni në gjuhën shqipe diplomën tuaj pranë një noteri në Shqipëri. Ju duhet të aplikoni në shërbimin: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=853 Njësimi i diplomave dhe certifikatave të lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë: Lexoni me kujdes udhëzimet për llojin e diplomes dhe hapat e procedurës për procesin e njehsimit, si dhe depozitoni dokumentacionin sipas udhëzimeve. Për çdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00, OSE NE LIVE CHAT në faqen tonë zyrtare https://www.adisa.gov.al/ . Faleminderit!	E plotë	Nuk ka
19	07.08.2023	Kërkesë për informacion për shtetësi shqiptarë	14.08.2023	Hello, In this link you will find information about the conditions you must fulfill to obtain citizenship: https://www.adisa.gov.al/albanian-citizenship/ then you can apply online in e-albania if you meet the conditions. This is the link of application: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=9627 For any further questions please contact us on our live chat at https://www.adisa.gov.al/ . Thank you!	E plotë	Nuk ka
20	08.08.2023	Kërkesë për informacion për hartë kadastrale	14.08.2023	Përhëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se institucioni përgjegjës dhe kompetent për kthim përgjigjet pasi aplikoni shërbimin për lëshim kopje të fragmentit të hartës kadastrale është ASHK. Për çdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!	E plotë	Nuk ka

21	09.08.2023	Kërkesë për informacion për leshim kopje karteles pasurie	14.08.2023	Përsëritet, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se pasi aplikoni në e-albania, afati ligjor i lëvrimin të shërbimit “Aplikim për leshim kopje karteles të pasurisë, është 5(pese) ditë pune. E vetmja mënyrë për të gjurmuar aplikimin është ajo nëpërmjet numrit të referencës. Në email-in Tuaj referoni se ky aplikim është bërë në datën 26.07.2021. Pra afati ligjor i lëvrimin të këtij shërbimi është tejkaluar. Për këtë, lutemi plotësoni ankesën në portalin e bashkëqeverisjes në linkun e mëposhtëm: https://www.shqiperiaqeduam.al/#shtetiNeSHerbim Për çdo pyetje apo paqartësi, na kontaktoni në kanal informativ pa pagesë 0800 0118, ose online chat, nga e hëna në të premte, në fashën orare 08.00 – 19.00. Faleminderit!	E plotë	Nuk ka
22	10.08.2023	Kërkesë për informacion për lidhje martesë	14.08.2023	Përsëritet, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se hapi i parë për lidhjen e martesës, është shpallja e martesës. Ju nuk keni specifikuar nëse partneri është shqiptar apo i huaj. Ndaj nuk e përcaktojmë dot nëse lidhja e martesës do trajtohet si martesë me shtetas shqiptar apo me të huaj . Po Ju nisim procedurat për të dyja rastet; - Në rastin e lidhjes së martesës me një shtetas shqiptar/e, Kërkesa për shpallje bëhet nga bashkëshortët e ardhshëm ose nga personi i caktuar nga ata me prokurë të posaçme. Shpallja e martesës bëhet nga të dy bashkëshortët e ardhshëm në zyrat e gjendjes civile në bashki / njësi administrative ku kanë vendbanimin. Gjatë shpalljes së martesës bashkëshortët e ardhshëm do të përcaktojnë se në cilën zyrë të gjendjes civile do të lidhet martesa. Dokumentacioni i nevojshëm për shpalljen e martesës midis dy shtetasve shqiptarë në republikën e Shqipërisë është: certifikatë lindje, me shënimin “për shpallje martesë”; fotokopje e dokumentit të identifikimit dhe jo pasaportë ; prokurë e posaçme, në rastet kur bashkëshortët e ardhshëm nuk janë prezent në procedurën e shpalljes; -Në rastin e lidhjes së martesës me një shtetas të huaj, Nga bashkëshorti i ardhshëm (shtetasi i huaj) paraqiten dokumentet për shpalljen e martesës, të legalizuar, përkthyer, noteruar: certifikatë lindje, e plotësuar me të gjithë përbërësit e gjendjes civile, që pasqyrohen në rubrikat e Regjistrat Kombëtar të Gjendjes Civile; dokumentin / certifikatë që vërteton se nuk ka pengesë ligjore në vendin e tij për lidhje martesë (vërtetim për leje lidhje martesë); dokument ku vërtetohen të	E plotë	Nuk ka

				dhënat e vendbanimit në shtetin e huaj; fotokopje e dokumentit të identifikimit; Këto dokumenta duhet të jenë me vulë APOSTILLE ose të legalizuar nga përfaqësitë tona diplomatike jashtë vendit. Dokumentacioni duhet të paraqitet i përkthyer dhe i noteruar. Shpallja e martesës kryhet në Bashki / Njësi Administrative, ku ka vendbanimin bashkëshorti i ardhshëm (shtetasi shqiptar). Pas kalimit të afatit 10 ditor nga e nesërmja e shpalljes, shtetasi shqiptar që do të lidhë martesë pajiset me dokumentacionin e mëposhtëm: certifikatë lindje; certifikatë lindje me shënimin “për lidhje martese”. Dokumentet duhet të legalizohen në institucionin e Prefekturës dhe në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe më pas bashkëshortët e ardhshëm ndjekin procedurën sipas legjislacionit të vendit ku do të lidhet martesa. Aplikimet për legalizimin e dokumenteve kryhen nëpërmjet Postës Shqiptare. Pas lidhjes së martesës në shtetin e huaj, dokumenti i martesës (certifikate martese/ekstrakt akt martese) i legalizuar, përcillet për regjistrim në shërbimin e gjendjes civile në Shqipëri në zyrën e gjendjes civile, ku bashkëshorti shqiptar ka vendbanimin. Kjo procedurë mundësohet online vetëm për shtetasit shqiptarë rezident në Itali. Për cdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!		
23	10.08.2023	Kërkesë për informacion për gjurmim aplikimi	14.08.2023	Pershendetje, Ne vijim te kerkeses tuaj per informacion, ju bejme me dije se, Nëse pasuria është e dixhitalizuar pas konfirmimit të kryerjes së pagesës përgjigja do ju shfaqet tek <i>Dokumentet e mia</i>, nëse jo pas konfirmimit të pagesës dhe kryerjes së verifikimeve përgjigja do ju shfaqet tek <i>Dokumentet e mia</i> brenda 1 ditë pune. Ju bejme me dije se, Pas kryerjes së aplikimit ju nuk duhet të prisni shërbimin postar për kthim-përgjigjen e aplikimit të kryer, por do të mund të merrni përgjigjen me vulë dhe firmë elektronike tek "Dokumentat e Mia" në profilin tuaj në e-Albania. Për të gjurmuar një aplikim të kryer në e-albania ju duhet të ndiqni vetëm dy hapa: Të ruani numrin e referencës (që e keni gjithmonë të ruajtur në sesionin “Mesazhet e mia” në e-albania). Të kërkonti shërbimin për të cilin ju keni kryer aplikimin. Pasi kërkonti shërbimin që ju keni kryer duhet të klikoni “Përdor” dhe më poshtë do t’ju shfaqet kjo tabelë: Mjafton që ju të vendosni numrin e referencës në hapsirën boshe dhe më pas të klikoni butonin	E plotë	Nuk ka

				“Gjurmo”. Në tabelën më poshtë do tju dalë emërtimi i shërbimit dhe statusi në të cilin ndodhet aplikimi juaj. Për cdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!		
24	11.08.2023	Kërkesë për informacion për lidhje martese	14.08.2023	Përhëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se hapi i parë për lidhjen e martesës, është shpallja e martesës. Ju nuk keni specifikuar nëse partneri është shqiptar apo i huaj. Ndaj nuk e përcaktojmë dot nëse lidhja e martesës do trajtohet si martesë me shtetas shqiptar apo me të huaj . Po Ju nisim procedurat për të dyja rastet; Në rastin e lidhjes së martesës me një shtetas shqiptar/e, Kërkesa për shpallje bëhet nga bashkëshortët e ardhshëm ose nga personi i caktuar nga ata me prokurë të posaçme. Shpallja e martesës bëhet nga të dy bashkëshortët e ardhshëm në zyrat e gjendjes civile në bashki / njësi administrative ku kanë vendbanimin. Gjatë shpalljes së martesës bashkëshortët e ardhshëm do të përcaktojnë se në cilën zyrë të gjendjes civile do të lidhet martesa. Dokumentacioni i nevojshëm për shpalljen e martesës midis dy shtetasve shqiptarë në republikën e Shqipërisë është: certifikatë lindje, me shënimin “për shpallje martese”; fotokopje e dokumentit të identifikimit dhe jo pasaporte ; prokurë e posaçme, në rastet kur bashkëshortët e ardhshëm nuk janë prezent në procedurën e shpalljes; Në rastin e lidhjes së martesës me një shtetas të huaj, Nga bashkëshorti i ardhshëm (shtetasi i huaj) paraqiten dokumentet për shpalljen e martesës, të legalizuar, përkthyer, noteruar: certifikatë lindje, e plotësuar me të gjithë përbërësit e gjendjes civile, që pasqyrohen në rubrikat e Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile; dokumentin / certifikatë që vërteton se nuk ka pengesë ligjore në vendin e tij për lidhje martese (vërtetim për leje lidhje martese); dokument ku vërtetohen të dhënat e vendbanimit në shtetin e huaj; fotokopje e dokumentit të identifikimit; Këto dokumenta duhet të jenë me vulë APOSTILLE ose të legalizuar nga përfaqësitë tona diplomatike jashtë vendit. Dokumentacioni duhet të paraqitet i përkthyer dhe i noteruar. Shpallja e martesës kryhet në Bashki / Njësi Administrative, ku ka vendbanimin bashkëshorti i ardhshëm (shtetasi shqiptar). Pas kalimit të afatit 10 ditor nga e nesërmja e shpalljes, shtetasi shqiptar që do të lidhë martesë pajiset me	E plotë	Nuk ka

				dokumentacionin e mëposhtëm: certifikatë lindje; certifikatë lindje me shënimin “për lidhje martesë”; Dokumentet duhet të legalizohen në institucionin e Prefekturës dhe në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe më pas bashkëshortët e ardhshëm ndjekin procedurën sipas legjislacionit të vendit ku do të lidhet martesa. Aplikimet për legalizimin e dokumenteve kryhen nëpërmjet Postës Shqiptare. Pas lidhjes së martesës në shtetin e huaj, dokumenti i martesës (certifikate martesë/ekstrakt akt martesë) i legalizuar, përcillet për regjistrim në shërbimin e gjendjes civile në Shqipëri në zyrën e gjendjes civile, ku bashkëshorti shqiptar ka vendbanimin. Kjo procedurë mundësohet online vetëm për shtetasit shqiptarë rezident në Itali. Për çdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!		
25	11.08.2023	Kërkesë për informacion për pension invaliditeti	14.08.2023	Pershendetje! Ne vijim te kerkeses tuaj per informacion, ju bejme me dije se, Gjate kohes qe eshte me raport nuk ka si ti jepet flete drejtimi per kemp. Pasi mbaron periudha ligjore e pajisjes me raporte periodike, mjeku duhet te jape flet drejtimi per kemp, shoqeruar edhe me epikrizen. Ne po u dergojme linkun ku aplikohet. Aplikim për pension invaliditeti (KMCAP):https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=6157 Për çdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!	E plotë	Nuk ka
26	14.08.2023	Kërkesë për informacion për regjistrimin e lejes së legalizimit	14.08.2023	Pershendetje! Në vijim të kërkesës tuaj për informacion ,Ju bëjmë me dije se, fillimisht duhet të aplikoni për të regjistruar lejen e legalizimit. Ju mund të aplikoni për këtë shërbim online përmes platformës qeveritare e-Albania Aplikim për regjistrimin e kalimit të pronësisë me anë të ligjit, me vendim të gjykatës, apo të një akti administrativ, në linkun: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=9444. Kërkoni shërbimin “Aplikim për regjistrimin e kalimit të pronësisë me anë të ligjit me vendim të gjykatës apo të një akti administrativ” dhe aplikoni duke plotësuar formularin elektronik që shfaqet në platformë dhe duke ngarkuar dokumentacionin e nevojshëm për lëvrimin e shërbimit. Në hapin e dytë shtohen automatikisht edhe këto shërbime: L1- Lëshim certifikate pronësie; I5- Lëshim kopje karte te pasurisë; I4- Lëshim kopje te fragmentit te	E plotë	Nuk ka

				hartës kadastrale. Dokumentacioni i nevojshëm për t`u ngarkuar është shkresa përcjellëse, ose në mungesë të saj leja e legalizimit. Leja e legalizimit ose çdo document tjetër duhet të ngarkohet në të gjitha rubrikat e detyrueshme në hapin e tretë. Aplikimi për regjistrimin e lejes së legalizimit dhe pajisjes me certifikatë pronësie nuk penalizohet me gjobë, por kujdes! Në hapin e tretë, si datë lëshimi të dokumentit do të vendosni datën e kryerjes së aplikimit të mësipërm. Në fund klikoni opsionin “Dërgo”. Shkarkoni mandatpagesën me të cilën mund të paraqiteni në bankë ose postë për të kryer pagesën ose kryeni pagesën online përmes portalit e-Albania me një kartë debiti ose kredit. Për çdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00.Faleminderit!		
27	14.08.2023	Kërkesë për informacion për bashkim familjar	14.08.2023	Përhëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se pasi keni bërë lidhjen e martesës, është partneri Juaj rezident në Itali që duhet të interesohet për procedurat e bashkimit familjar atje. Ju nga ana juaj nuk mund të bëni veprime për bashkim familjar në Itali Për çdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!	E plotë	Nuk ka
28	14.08.2023	Kërkesë për informacion për Aplikim për çrregjistrimin e personit fizik	14.08.2023	Përhëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se për të bërë mbylljen përfundimtare të biznesit si person fizik, duhet të aplikoni nga llogaria Juaj në e-albania shërbimin, "Aplikim për çrregjistrimin e personit fizik", në linkun e mëposhtëm:https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=13893 Nëse kërkonti pezullimin e përkohshëm të aktivitetit, aplikoni shërbimin, "Aplikim për njoftim për pushimin e përkohshëm të aktivitetit", në linkun e mëposhtëm: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=13678 Për çdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00.Faleminderit!	E plotë	Nuk ka
29	14.08.2023	Kërkesë për informacion për Raportet e barrëlindjes	14.08.2023	Përhëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se nëse jeni e vetpunësuar kur të merrni raportet e paralindjes dhe më pas ato të paslindjes do të aplikoni nga llogaria Juaj në e-albania shërbimin Kërkesë për shpërblim lindje për personat e vetëpunësuar, Nëse jeni e punësuar,	E plotë	Nuk ka

				financieri i subjektit ku jeni e punësuar aplikon shërbimin Kërkesë për shpërblim lindje për personat e punësuar , Punonjësi i ISSH-së njoftohet elektronikisht për mbërritjen e dosjes se re, verifikon saktësinë e dokumenteve dhe kthen përgjigje me e-mail për rezultatin e aplikimit. Nëse ka pasaktësi ose mungesë dokumentesh, punonjësi i ISSH-së njofton aplikantin për pasaktësitë dhe e udhëzon për të riplotësuar praktikën e aplikimit Dokumentet origjinale që i keni bashkëlidhur gjatë aplikimit duhet të dërgohen me postë pranë DRSSH përkatëse. Mbani në konsideratë që zarfi i përcjelljes së këtyre dokumenteve të shoqërohet me numrin e aplikimit të shërbimit në e-albania Nga sa më sipër, pas kryerjes së aplikimit në e-albania, dhe dërgimit me postë të raportit mjekësor, kompetenca dhe përgjegjësia për pagesën e raporteve i kalon Institutit të Sigurimeve Shoqërore . Për çdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!		
30	14.08.2023	Kërkesë për informacion për Aplikim për letërnjoftim elektronik	14.08.2023	Përhëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion , Ju bëjmë me dije se procedura e pajisjes me letërnjoftim elektronik(kartë identiteti) është si më poshtë: - Nëse pajisja me kartë identiteti është për herë të parë, duhet të paraqiteni pranë gjendjes civile, dhe të pajiseni me vërtetim si banor i njësisë. Më pas: Blini kuponin në sportelet e postës shqiptare Paraqituni pranë Identitek pranë njësisë Tuaj dhe vazhdoni procedurën. Sjellim në vëmendje se kur është pajisje për herë të parë, duhet të paraqiteni vetëm në pikën IdentiTek që i korrespondon qytetit tuaj dhe njësisë Tuaj administrative - Në rasti Tuaj, që keni rinovim të letërnjoftimit elektronik, mjafton të blini kuponin dhe të paraqiteni në çdo pikë IdentiTek . Për çdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!	E plotë	Nuk ka
31	14.08.2023	Kërkesë për informacion për Portalin Me ty Për Shqipërinë Që Duam	14.08.2023	Përhëndetje, Në vijim të kërkesës tuaj për informacion, ju bëjmë me dije se, për mosofrim të shërbimit në afatin ligjor të parashikuar, dërgoni ankesën Tuaj në portalin "Me ty për Shqipërinë që duam", në linkun e mëposhtëm: https://www.shqiperiaqeduam.al/#shtetiNeSHerbim Për çdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!	E plotë	Nuk ka

32	15.08.2023	Kërkesë për informacion për leje ndërtimi	15.08.2023	Përsëndetje! Në vijim të kërkesës tuaj për informacion, ju bëjmë me dije se, ju duhet të aplikoni për leje ndërtimi përmes portalit e-albania. Bashkëlidhur keni linkun për të aplikuar. Kujdes! Fillimisht duhet të zgjidhni një nga llojet e lejeve që do aplikoni dhe sipas saj do aplikoni me dokumentacionin përkatës. Shikoni me vëmendje tipet e lejeve dhe cila ju përshtatet: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=6093 Për çdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00, ose live chat online në faqen tonë zyrtare https://www.adisa.gov.al/ . Faleminderit	E plotë	Nuk ka
33	15.08.2023	Kërkesë për informacion për Portalin Me ty Për Shqipërinë Që Duam	15.08.2023	Përsëndetje, Në vijim të kërkesës tuaj për informacion, ju bëjmë me dije se, për mosfrim të shërbimit në afatin ligjor të parashikuar, dërgoni ankesën Tuaj në portalin "Me ty për Shqipërinë që duam", në linkun e mëposhtëm: https://www.shqiperiaqeduam.al/#shtetiNeSHerbim Për çdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!	E plotë	Nuk ka
34	15.08.2023	Kërkesë për informacion për informacion për trungun familjar	18.08.2023	Hello, You are contacting the <i>Agency for the Delivery of Integrated Services Albania</i> . This public institution gives information about public services offered from Albanian government for their citizens and foreign citizens who want to live/work in the Republic of Albania. Please contact us on our live chat online, so we can get more details of your case to help you. You can find us on: https://www.adisa.gov.al/ Thank you!	E plotë	Nuk ka
35	15.08.2023	Kërkesë për informacion mbi lidhjen e martesës	18.08.2023	Përsëndetje, Ju lutemi na kontaktoni në adresën tonë online, në live chat, për të komunikuar drejtpërdrejt me ne në mënyrë që të mund t'ju ndihmojmë me problematikën tuaj. Bashkëlidhur linku për live chat: https://www.adisa.gov.al/ Faleminderit!	E plotë	Nuk ka
36	15.08.2023	Kërkesë për informacion për certifikatë pronësie	18.08.2023	Përsëndetje! Në vijim të kërkesës tuaj për informacion, ju bëjmë me dije se, nëse e keni faturën ku keni bërë pagesat e mandatit fillestar, ju duhet të kontrolloni në portalin e-albania në llogarinë e babait tuaj për të parë nëse ju është kthyer përgjigje në seksionin Dokumentat e Mia. Pikërisht nëse e dispononi faturën, ju thjesht mund të bëni një AV0 aplikim pa pagesë mbi aplikimin që keni bërë. Në rast se jo, ju lutemi na kontaktoni në live chat-online që të komunikojmë live për rastin tuaj dhe t'ju udhëzojmë për hapat që do ndiqni. Për çdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë	E plotë	Nuk ka

				0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00, ose na kontaktoni ne live-chat online ne faqen tone zyrtare https://www.adisa.gov.al/ Faleminderit!		
37	15.08.2023	Kërkesë për informacion për raport mjeko-ligjor	18.08.2023	Përhëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se për të pajisur me raport Mjeko-Ligjor, duhet të paraqiteni tek mjeku i familjes. Në kërkesën Tuaj nuk keni referuar arsyen e pajisjes me këtë dokument. Nëse e keni për pajisje për herë të parë apo rinovim të lejes së drejtmit, duhet të keni me vete edhe 2(dy) copë fotografi format dokument 4x5. Pasi realizoni kontrollet sipas rekomandimeve të mjekut të familjes për mjekët specialistë, raportin e shkarkoni ne seksionin Dokumentet e mia në llogarinë Tuaj në e-albania. Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!	E plotë	Nuk ka
38	15.08.2023	Kërkesë për informacion për passaportë biometrike për ndryshim gjeneralitetesh	18.08.2023	Përhëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion ,Ju bëjmë me dije se, pasi të bleni kuponin në postë, nuk do të rezervoni takim për t'u paraqitur fizikisht me qëllim vijimin e aplikimit., pasi subjekti IdentiTek, ende nuk e ka një link ku të rezervoni. Paraqituni pa lënë takim, duke pasur me vete pasaportën aktuale dhe kuponin. Pas aplikimit, mund të gjurmoni statusin e aplikimit nëpërmjet numrit të referencës së aplikimit. Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!	E plotë	Nuk ka
39	15.08.2023	Kërkesë për informacion për Njehsimi i diplomës nga IAL	18.08.2023	Pershendetje! Ne vijim te kerkeses tuaj per informacion, ju bejme me dije se ju nuk keni specifikuar llojin e shreibimit qe keni aplikuar per njehsimin e diplomave perkatese. Megjithate ju bejme me dije se per te kryer njehsimin e diplomave perkatese, ju duhet te keni aplikuar per dy sherbimet e meposhtme ne portalin e-albania: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=14156 - per deftesen e ciklit parauniversitar, https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=853 - per diplomen universitare. Nese keni ndjekur kete rruge dhe nuk keni marre pergjigje ne llogarine tuaj ne portalin e-albania, atehere ju mund te kryeni nje ankese tek portalin Me Ty Per Shqiperine Qe duam, per mosofrim te sherbimit brenda kohes se duhur. Bashkelidhur linku: https://www.shqiperiaqeduam.al/ .	E plotë	Nuk ka

				Gjithsesi, ju mund te kontaktoni edhe vet QSHA per te shpjeguar problematiken tuaj, ne adresen Agim.alia@qsha.gov.al . Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!		
40	15.08.2023	Kërkesë për informacion për Rregjistrim AMTP	18.08.2023	Përhëndetje, Në vijim të kërkesës tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije Fillimisht duhet të aplikoni për të regjistruar aktin e marrjen ne perdorim te tokes (AMTP). Ju mund të aplikoni për këtë shërbim online përmes platformës qeveritare e-Albania në linkun: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=9444 Kërkoni shërbimin “ Aplikim për regjistrimin e kalimit të pronësisë me anë të ligjit me vendim të gjykatës apo të një akti administrativ ” dhe aplikoni duke plotësuar formularin elektronik që shfaqet në platformë dhe duke ngarkuar dokumentacionin e nevojshëm për lëvrimin e shërbimit. Në hapin e dytë shtohen automatikisht edhe këto shërbime: L1- Lëshim certifikate pronësie; I5- Lëshim kopje karte te pasurisë; I4- Lëshim kopje te fragmentit te hartës kadastrale. Dokumentacioni i nevojshëm për t`u ngarkuar është AMTP, certifikate familjare ne daten 01.08.1991. Plan rilevimi. AMTP dhe çdo document tjetër që duhet të ngarkohet në të gjitha rubrikat e detyrueshme në hapin e tretë. Pavarësisht se si i kanë emërtimet dokumentat që duhen ngarkuar në hapin e tretë, do të ngarkoni dokumentat që keni. Aplikimi për regjistrimin e AMTP dhe pajisjes me certifikatë pronësie nuk penalizohet me gjobë, por kujdes! Në hapin e tretë, si datë lëshimi të dokumentit do të vendosni datën e kryerjes së aplikimit të mësipërm. Në fund klikoni opsionin “Dërgo”. Shkarkoni mandatpagesën me të cilën mund të paraqiteni në bankë për të kryer pagesën ose kryeni pagesën online përmes portalit e-Albania me një kartë debiti ose kredit. Pasi realizoni pagesën, një kopje të mandatit, dhe dokumentet që u kemi cituar më sipër duhet t`i dërgoni me postë pranë ASHK, duke vendosur mbi zarf edhe numrin e referencës së aplikimit. Për cdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit.	E plotë	Nuk ka
41	21.08.2023	Kërkesë për informacion për vërtetim legalizimi	21.08.2023	Përhëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se per te marre konfirmimin e informacionit qe kerkoni, duhet te aplikoni nga llogaria Juaj ne e-albania sherbimin: Vertetim per aplikim per legalizim ndertimi informal, ne linkun e meposhtem:		

				albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=12411 Gjate aplikimit do te ngarkoni ne format PDF, dokumentin e vetdeklarimit. Nese nuk e dispononi kopjen e vetdeklarimit, hartoni nje kerkese me shkrim ku te citoni faktin se nuk e dispononi kopjen. Kete kerkese ngarkojeni tek opsioni i kopjes se dokumentit, dhe prisni pergjigjen e ASHK. Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!		
42	21.08.2023	Kërkesë për informacion për numer matrikullimi	21.08.2023	Përsëndetje,Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion ,Ju bëjmë me dije se duhet të kontaktoni në me rektoratin. Rektorati është institucioni i kompetencës për t`Ju pajisur me informacionin që kërkon. Për çdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!	E plotë	Nuk ka
43	21.08.2023	Kërkesë për informacion për gjenerim passwordi	21.08.2023	Përsëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se nëse nuk arrini të logoheni (futeni) në llogarinë Tuaj në e-albania, nëse nuk keni aktive asnjë nga të dhënat e regjistrimit(adresë email dhe numër telefoni) për të gjeneruar një password të ri duhet të veproni si më poshtë: Hapni një adresë të re email dhe dërgoni këto të dhëna në adresën: helpdesk@e-albania.al : - foto të kartës ID - emri i nënës - emri i babait - vendlindja e nënës. Specifikoni adresën e re email dhe numrin e telefonit që doni të përdorni në vazhdim për llogarinë tuaj në portal. Brenda 5(pesë) ditëve adresa ku keni dërguar email-in do t`Ju pajisë me një kod katërshifror me anë të të cilit zhbllkohet llogaria dhe u jep të drejtën të vendosni një fjalëkalim të ri. Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!	E plotë	Nuk ka
44	21.08.2023	Kërkesë për informacion për llogari e-albania	21.08.2023	Përsëndetje,Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion ,Ju bëjmë me dije se dokumentet në opsionin, "Dokumentet e mia" nëse i keni fshirë, nuk mund të rikthehen. Duhet të riaplikoni për t'u pajisur me dokumentet që u interesojnë. Për çdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!	E plotë	Nuk ka
45	21.08.2023	Kërkesë për informacion për pension pleqerie	21.08.2023	Përsëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion ,Ju bëjmë me dije se sportelet ADISA janë mbyllur që nga data 1 Maj 2022. Lidhur me problemin Tuaj, mundohuni të gjeni ndonjë familjar apo të afërm që është përdorues	E plotë	Nuk ka

				interneti, dhe më pas të kontaktojë me specialistët e sektorit tonë. Ne do t'ju udhëzojmë nga fillimi deri në fund të aplikimit. Për çdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!		
46	21.08.2023	Kërkesë për informacion për leje ndertimi	21.08.2023	Pershendetje, Ju lutem na kontaktoni ne faqen zyrtare https://www.adisa.gov.al/ per te folur ne kohe reale me ne, ne menyre qe tju informojme ne detaje per rastin tuaj. Faleminderit!		
47	21.08.2023	Kërkesë për informacion për certificate trangu familjar	21.08.2023	Përsëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se Certifikatat e Trngut Familjar nuk mundësohen në e-albania. Për këto certifikata, procedohet si më poshtë: Për qytetaret e Tiranës, certifikatat merren tek Bashkia Tiranë. Për rrethinat e Tiranës merren tek Prefektura Tiranë. Për të gjitha Bashkitë e Komunat e tjera në territorin e Shqipërisë, certifikatat merren pranë Prefekturave të Qarqeve respektive. Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!	E plotë	Nuk ka
48	22.08.2023	Kërkesë për informacion për ngarkim dokumentacioni në e-albania	22.08.2023	Pershendetje, Per problematika lidhur me aksesimin dhe funksionimin e portalit e-albania, ju lutem kontaktoni n email suportin teknik te portalit, helpdesk@e-albania.al. Faleminderit!	E plotë	Nuk ka
49	23.08.2023	Kërkesë për informacion për lidhje martese	24.08.2023	Pershendetje, Ne vijim te kerkeses tuaj per informacion, ju bejme me dije se, Në rastin e lidhjes së martesës me një shtetas të huaj, nga bashkëshorti i ardhshëm (shtetasi i huaj) paraqiten dokumentet e mëposhtme për shpalljen e martesës (të legalizuar, përkthyer dhe noterizuar): Certifikatë lindje, e plotësuar me të gjithë përbërësit e Gjendjes Civile, që pasqyrohen në rubrikat e Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile; Dokumentin / Certifikatë që vërteton se nuk ka pengesë ligjore në vendin e tij për lidhje martese (vërtetim për leje lidhje martese);Dokument ku vërtetohen të dhënat e vendbanimit në shtetin e huaj; Fotokopje e dokumentit të identifikimit. Këto dokumenta duhet të jenë me vulë APOSTILE ose të legalizuar nga përfaqësitë tona diplomatike jashtë vendit. Dokumentacioni duhet të paraqitet i përkthyer dhe i noterizuar. Shpallja e martesës kryhet në Bashki / Njësi Administrative, ku ka vendbanimin bashkëshorti i ardhshëm (shtetasi shqiptar). Pas kalimit të afatit	E plotë	Nuk ka

				10 ditor nga e nesërmja e shpalljes, shtetasi shqiptar që do të lidhë martesë pajiset me dokumentacionin e mëposhtëm: Certifikatë lindje; Certifikatë lindje me shënimin “për lidhje martese”. Dokumentet duhet të legalizohen në institucionin e Prefekturës dhe në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe më pas bashkëshortët e ardhshëm ndjekin procedurën sipas legjislacionit të vendit ku do të lidhet martesa. Aplikimet për legalizimin e dokumenteve kryhen nëpërmjet Postës Shqiptare. Pas lidhjes së martesës në shtetin e huaj, dokumenti i martesës (certifikatë martese /ekstrakt akt martese) i legalizuar, përcillet për regjistrim në shërbimin e Gjendjes Civile në Shqipëri, në zyrën e Gjendjes Civile, ku bashkëshorti shqiptar ka vendbanimin. Afati i vlefshmërisë për lidhjen e martesës së shpallur është 1 vit. Për çdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit		
50	25.08.2023	Kërkesë për informacion për afati ligjor i lëvrimit të shërbimit	25.08.2023	Përsëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se pasi realizoni aplikimin, përgjegjësia dhe kompetenca për kthimin e përgjigjes dhe respektimin e afatit ligjor i takon institucionit të cilit i drejtohet aplikimi. Në rastin Tuaj, Agjencisë Shtetërore të Kadastrës. Mandat pagesa ka të cilësuar dhe afatin ligjor të marrjes së shërbimit. Nëse ka kaluar ky afat, dërgoni ankesën Tuaj në portalin e bashkëqeverisjes. https://www.shqiperiaqeduam.al/#shtetiNeSHerbim Për çdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!	E plotë	Nuk ka
51	25.08.2023	Kërkesë për informacion për rregjistrim i aktit të trashëgimisë	25.08.2023	Përsëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion referuar problematikës, Ju bejme me dije se fillimisht duhet të bëni çeljen e aktit të trashëgimisë tek noteri. Më pas, në cilësinë e trashëgimtarit ligjor, shërbimi që duhet të aplikoni është regjistrimi i aktit të trashëgimisë përmes platformës qeveritare e-Albania në linkun: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=9467 duke kërkuar shërbimin " Aplikim për regjistrim të aktit të trashëgimisë " Aplikoni duke plotësuar formularin elektronik që shfaqet në platformë duke ngarkuar dokumentacionin e nevojshëm për lëvrimin e shërbimit. Kujtesë! Në hapin e dytë duhet të shtoni edhe këto shërbime:	E plotë	Nuk ka

				R2- Aplikim për regjistrimin e kalimit të pronësisë me anë të ligjit, me vendim të gjykatës, apo të një akti administrativ L1- Lëshim certifikate pronësie I5- Lëshim kopje karteles të pasurisë I4- Lëshim kopje të fragmentit të hartës kadastrale Perfundoni aplikimin duke dhënë komanden Dergo. Aktin original të trashëgimisë, Lejen e legalizimit, dhe kopje të të gjitha dokumentave që keni, duhet t'i dërgoni me postë në adresë të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës duke vendosur mbi zarf numrin e aplikimit të shërbimit në e-albania. Për çdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!		
52	28.08.2023	Kërkesë për informacion për lidhje martesë	28.08.2023	Përhëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se hapi i parë për lidhjen e martesës, është shpallja e martesës. Ju nuk e keni specifikuar nëse lidhja e martesës do të jetë me shtetas/e shqiptar/e apo me të huaj . Po Ju nisim procedurat për të dyja rastet;- Në rastin e lidhjes së martesës me një shtetas shqiptar/e, Kërkesa për shpallje bëhet nga bashkëshortët e ardhshëm ose nga personi i caktuar nga ata me prokurë të posaçme. Shpallja e martesës bëhet nga të dy bashkëshortët e ardhshëm në zyrat e gjendjes civile në bashki / njësi administrative ku kanë vendbanimin. Gjatë shpalljes së martesës bashkëshortët e ardhshëm do të përcaktojnë se në cilën zyrë të gjendjes civile do të lidhet martesa. Dokumentacioni i nevojshëm për shpalljen e martesës midis dy shtetasve shqiptarë në republikën e Shqipërisë është: certifikatë lindje, me shënimin “për shpallje martesë” fotokopje e dokumentit të identifikimit dhe jo pasaportë ; prokurë e posaçme, në rastet kur bashkëshortët e ardhshëm nuk janë prezent në procedurën e shpalljes; -Në rastin e lidhjes së martesës me një shtetas të huaj, Nga bashkëshorti i ardhshëm (shtetasi i huaj) paraqiten dokumentet për shpalljen e martesës, të legalizuara, përkthyer, noteruar: 1. certifikatë lindje, e plotësuar me të gjithë përbërësit e gjendjes civile, që pasqyrohen në rubrikat e Regjistrat Kombëtar të Gjendjes Civile; 2. dokumentin / certifikatë që vërteton se nuk ka pengesë ligjore në vendin e tij për lidhje martesë (vërtetim për leje lidhje martesë); 3. dokument ku vërtetohen të dhënat e vendbanimit në shtetin e huaj; 4. fotokopje e	E plotë	Nuk ka

				dokumentit të identifikimit; Këto dokumenta duhet të jenë me vulë APOSTILLE ose të legalizuar nga përfaqësitë tona diplomatike jashtë vendit. Dokumentacioni duhet të paraqitet i përkthyer dhe i noteruar. Shpallja e martesës kryhet në Bashki / Njësi Administrative, ku ka vendbanimin bashkëshorti i ardhshëm (shtetasi shqiptar). Pas kalimit të afatit 10 ditor nga e nesërmja e shpalljes, shtetasi shqiptar që do të lidhë martesë pajiset me dokumentacionin e mëposhtëm: 1. certifikatë lindje; 2. certifikatë lindje me shënimin “për lidhje martese”; Dokumentet duhet të legalizohen në institucionin e Prefekturës dhe në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe më pas bashkëshortët e ardhshëm ndjekin procedurën sipas legjislacionit të vendit ku do të lidhet martesa. Aplikimet për legalizimin e dokumenteve kryhen nëpërmjet Postës Shqiptare. Pas lidhjes së martesës në shtetin e huaj, dokumenti i martesës (certifikate martese/ekstrakt akt martese) i legalizuar, përcillet për regjistrim në shërbimin e gjendjes civile në Shqipëri në zyrën e gjendjes civile, ku bashkëshorti shqiptar ka vendbanimin. shpallja e martesës online bëhet vetëm për shqiptarët rezidentë në Itali. Për të gjithë rastet e tjerë ndiqet procedura e mësipërme. https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=9781 Për cdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!		
53	28.08.2023	Kërkesë për informacion për aplikim për vërtetim pronësie negativ/pozitiv	28.08.2023	Pershendetje! Na kontaktoni ne live chat ne faqen tone zyrtare adisa.gov.al ne menyre qe t'ju ndihmojme me problematiken tuaj. Faleminderit!	E plotë	Nuk ka
54	29.08.2023	Kërkesë për informacion për certifikatë të gjendjes gjyqësore	29.08.2023	Përsëndetje, Në vijim të kërkesës tuaj për informacion, ju bëjmë me dije se, ju duhet të aplikoni pranë portalit e-albania për të perftuar Certifikatë të Gjendjes Gjyqësore. Hapat e procedurës I. Në rast se jeni shtetas shqiptar lutemi të ndiqni hapat e mëposhtme: - Identifikohuni si qytetar ose si biznes në portalin e-Albania; - Zgjidhni shërbimin "Certifikatë e Gjendjes Gjyqësore (dëshmia e penalitetit)/ Judicial	E plotë	Nuk ka

				Records Certificate"; - Klikoni butonin "Përdor"; - Përzgjidhni tipin e aplikimit "Aplikim për veten" ose "Aplikim për fëmijën 14 - 15 vjeç". - Plotësoni formularin elektronik dhe klikoni "Dërgo". Dëshmia me vulë elektronike dërgohet në seksionin "Dokumentet e mia" te hapësira juaj në portalin e-Albania. II. <i>Në rast se jeni shtetas i huaj lutemi të ndiqni hapat e mëposhtme:</i> - Zgjidhni shërbimin "Certifikatë e Gjendjes Gjyqësore (dëshmia e penalitetit)/ Judicial Records Certificate"; - Zgjidhni shtetësinë tuaj duke klikuar butonin përkatës; - Kliko butonin "Continue with the application"; - Kliko butonin "Aplikim i ri/Apply"; - Plotësoni formularin elektronik; - Ngarkoni dokumentin e identifikimit dhe klikoni "Dërgo – Send"; - Në rast se konstatohet se të dhënat e plotësuara në formular nuk përputhen me të dhënat në dokumentin identifikues, aplikimi do të refuzohet dhe do të dërgohet email ku do të kërkohet të aplikoni përsëri dhe të vendosni të dhënat e sakta sipas dokumentit bashkëlidhur. Dëshmia me vulë elektronike do të dërgohet në adresën e postës elektronike që keni specifikuar në formular. Koha e nevojshme e marrjes së shërbimit 3 - 5 ditë nga momenti i hyrjes në Sektorin e Gjendjes Gjyqësore. Ne rast se nuk keni llogari te hapur ne portalin e-albania, ju bejme me dije se fillimisht duhet te krijoni nje llogari tuajen. Per kete ndiqni hapat e meposhtme: Pasi të jetë hapur portali www.e-albania.al duhet të ndiqen hapat e mëposhtëm: a. Klikoni "Regjistrohu/Register" b. Plotësoni të gjitha të dhënat e specifikuar në formularin e regjistrimit c. Kodi i përdoruesit (NID: Numri personal i identifikimit) / User Personal Identification Number (NID) : Është numri personal i identifikimit. d. Data e skadimit të kartës së identitetit / Identification document expiry date: Vendosni datën e skadimit të kartës së identitetit në formatin datë.muaj.vit. e. Fjalëkalimi / Password: Sigurohuni që fjalëkalimi të jetë 8 deri në 12 karaktere i gjatë dhe nuk duhet të fillojë ose mbarojë me hapësira. f. E-mail: Në këtë adresë do të vijë linku i aktivizimit të llogarisë dhe të gjitha njoftimet që kanë të bëjnë me aplikimet tuaja.g. Numri i celularit / Mobile phone number: Sigurohuni që të vendoset në formatin e duhur. Për numrat shqiptarë formati është '06xxxxxxxx' ndersa për numrat jashtë Shqipërisë, formati i saktë është '0044/0039/0032xxxxxxxx', në varësi të shtetit ku jetoni. h. Të dhënat personale (Emri / Name, Mbiemri / Surname,		
--	--	--	--	---	--	--

				Atësia / Father Name, Mëmësia / Mother Name, Datëlindja / Birthdate): Duhet të bëhet kujdes që të gjitha të dhënat të jenë të sakta dhe të përputhen më të dhënat e Regjistrimit të Gjendjes Civile. i. * Kujdes me të dhënat që mund të kenë "ë", ose "ç". j. Nëse edhe pas verifikimit të të dhënave tuaja në Gjendjen Civile do të keni vështirësi me regjistrimin kontaktoni ne adresen : helpdesk@e-albania.al. k. Plotësoni kodin katër shifror të dërguar me SMS në numrin tuaj të telefonit dhe klikoni në linkun e aktivizimit në adresën tuaj e- mail për aktivizimin e llogarisë tuaj. Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00, ose na kontaktoni ne live chat ne faqen tone zyrtare https://www.adisa.gov.al/ , qe tju asistojme me tej me proceduren. Faleminderit!		
--	--	--	--	--	--	--